



A.nr. 517/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malësore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtare me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.517/2026 të datës 12.05.2026, të parashtruar nga ankuesi T.P, kundër organit të punësimit: Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, në çështjen juridik ‘kontestim konkursi’, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 21.07.2026, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.517/2026, e datës 12.05.2026, e parashtruar nga ankuesi T.P.

A r s y e t i m

Ankuesi, T.P (me tej referuar vetëm ankuesi), më datë 12.05.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjë A.nr. 517/2026, me pretendimet ankimore lidhur me konkursin RN00019429, të datës 12.03.2026 për Grupin e Inxhinierisë Minerale, për pozitën ‘Inspektor i Minerave’, Profesional 1, të zhvilluar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 21.05.2026 e ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, ndërsa kjo e fundit, më datë 22.05.20256, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën A.nr.517/2026 të datës 12.05.2026; drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin

e datës 30.04.2026; Kopjen e Letërnjoftimit për ankuesin T.P; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 21.05.2026, dërguar nga S.A, për F.M; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 517/2026, e datës 25.05.2026; Njoftimi për anulimin e konkursit i datës 20.05.2026; Vendimi i datës 18.05.2026; Konkursi me numër reference RN00019429, i datës 12.03.2026; Njoftimi i datës 30.04.2026; Lista e Aplikantëve; Vendimi i datës 24.04.2026; Njoftimi i datës 30.04.2026; Aplikacioni i T.P, me shkesat e bashkangjitura; Certifikatat e ankuesit; Diplomë me numër protokolli 385, e datës 27.10.2014, për T.P, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “ Hasan Prishtina”; Diplomë me numër protokolli 23, e datës 02.02.2018, për T.P, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “ Hasan Prishtina”; Kontratë e punës për T.P; Pasqyra e Trustit për T.P, për periudhën nga data 26.01.2026, deri me datën 21.06.2024; Rekomandim i datës 14.08.2018; Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë për vitin 2017; Vërtetim i datës 20.06.2024.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e palejuar, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, më datë 12.03.2026, ka shpallur konkursin me numër reference RN00019429 për emrin e grupit “Grupi i Inxhinierisë Minerale, pozita e punës “ Inspektor i Minierave”, klasa Profesional 1, numri i kërkuar (1). Konkursi ka qenë i hapur për aplikim nga data 13.03.2026 deri me 11.04.2026, e në të cilin konkurs kishte aplikuar edhe ankuesi.

Ankuesi me datë 12.05.2026, parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore kundër njoftimit lidhur me refuzimin e aplikacionit, nga ana e KPMM, sepse ankuesi nuk ka kompletuar me dokumentacione aplikacionin.

Në kuptim të pranueshmerisë së ankesës Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të nenit 39 paragrafi 12 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, me të cilin është përcaktuar se: ...12. *Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative..* si dhe nenit 17 të Rregullores Nr. 07/2025 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil., me të cilin shprehimisht parashihet se: *Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve, në rast të pakënaqësive me procesin e rekrutimit ka të drejtë të parashtoj ankesë vetëm pas shpalljes së rezultateve përfundimtare, ndërsa, në rastin konkret ankesa është parashtruar me datë 12.05.2026, ndërsa procedura sipas konkursit me referencë RN00019429 nuk është përfunduar ende, dhe se ankuesi ankesën e ka parashtruar në Këshill si të parrokshme, ashtu siç e përcaktojnë dispozitat ligjore në fuqi, andaj mbi bazën e kësaj rezulton se ankesa e ankuesit është e parakohshme, dhe si e tillë është e palejueshëm në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.*

Theksuar si me sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L 048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendoi si në dispozitivin e këtij.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA: A.nr. 517/2026

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit T.P.
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së